

Fatmir Xheladini, PHD¹

UDC: 327.51(100-622HATO:497.7)
341.171(4-672EY:497.7)

**IDENTITETI DHE SIGURIA:
NDËRTHURJA E PERCEPTIMIT, KONFLIKTIT DHE POLITIKËS**

**ИДЕНТИТЕТ И БЕЗБЕДНОСТ: ВПЛЕТУВАЊЕ НА
ПЕРЦЕПЦИЈАТА, КОНФЛИКТТОТ И ПОЛИТИКАТА**

**IDENTITY AND SECURITY: THE INTERWEAVING OF
PERCEPTION, CONFLICT, AND POLITICS**

Abstract

This article explores the intersection between identity and security within the framework of contemporary international relations theories, with a particular focus on the concept of collective security. Through an analysis of theoretical approaches such as security communities, institutionalism, and functionalism, the study aims to clarify how states, by sharing common values, norms, and practices, develop a sense of collective security. The case of North Macedonia is examined as a relevant example of a state in transition toward European and Euro-Atlantic collective security structures, through its integration into the European Union and NATO.

Keywords: *identity, collective security, security community, integration, institutionalism, North Macedonia, NATO, EU.*

1. Hyrje

Në dekadat e fundit, identiteti është bërë një komponent qendror i analizës së sigurisë. Në vend të konceptimit të sigurisë vetëm përmes kërcënimeve të jashtme ushtarake, studiuesit kanë theksuar rolin e ndërtimit të identitetit në formësimin e perceptimeve të sigurisë. Sipas teorisë së komuniteteve të

¹ Ligjërues në Fakultetin Juridik, Universiteti i Tetovës.

sigurisë të Karl Deutsch, siguria e përbashkët ndërtohet përmes besimit reciprok dhe ndarjes së normave dhe vlerave, ku shtetet nuk fokusohen të përdorin dhunën ndaj njëri-tjetrit (Deutsch et al., 1957).

Konceptet e deriatëhershme, të bazuara mbi shtetin dhe fuqinë dhe të fokusi i tyre mbi aspektet ushtarake të sigurisë, nuk arritën të marrin parasysh kërcënimet e ndryshme joushtarake që filluan të paraqiteshin si rezultat i ndryshimeve në rendin global, i vendosur mbi premisat e aspekteve ushtarake mbi sigurinë. Shqetësimet e reja, të vendosura në stade shumëpërmasore të ndërveprimit të shteteve dhe popujve, prodhuan mospajtime dhe perceptime në një gjendje të vazhdueshme transformimi në nivel global, rajonal dhe lokal. Shumë prej shteteve në ndërtim e sipër apo në proces tranzicioni, që u sfiduan nga këto paraqitje në nivel global, dështuan që t'i marrin në konsideratë ato, ose në raste të ndryshme nuk ishin as në gjendje të përballonin sfidat që ia behën, dhe si rrjedhojë problemet nisën të shfaqen rishtazi duke nxitur konflikte etnike, siç qe rasti me ish-Jugosllavinë e më gjerë.

Pavarësisht qasjeve të ndryshme të formimit të shtetit dhe të shtet-ndërtimit, që shtetet e sapo krijuara apo në tranzicion kanë ndërmarrë pas Luftës së Ftohtë, ato përsëri kishin prirjen që të angazhoheshin në një formë shtetndërtimi apo sigurie në një mënyrë që kërkonte ndryshimin e gjendjes së grupit dominues etnik, duke përdorur mekanizmat institucionalë të shtetit. Kjo prirje drejt privilegjit etnik, shpesh ka treguar një preferencë të dukshme për homogjenizimin dhe diskriminimin në procesin e ndërtimit të shtetit. Në të shumtën e rasteve kjo ka ndodhur nëpërmjet një qasjeje të heshtur, duke miratuar politika diskriminuese ndaj grupeve të vogla dhe duke çuar në konsolidimin e ngadalshëm të grupeve të mëdha në hierarkinë e shtetit.

Një rast të veçantë në këtë drejtim përbën edhe Republika e Maqedonisë së Veriut pas shpalljes së pavarësisë në vitin 1991. Ajo pati sukses në shmangien e një përplasjeje të armatosur në fillim të viteve '90, si rrjedhojë e kërcënimeve të atëhershme të ushtrisë Jugosllave, ndonëse mosidentifikimi i drejtë i sfidave të brendshme nga lidhshipi shtetëror i hapi rrugën një revolte të armatosur shqiptare në vitin 2001. Kjo zhvendosje e gjendjes së sigurisë përbën një moment të rëndësishëm analize për shkaqet dhe arsyet e evoluimit të pasigurisë së Maqedonisë nga siguria e jashtme te pasiguria e brendshme, dhe në distancë kohore me paraqitje të ndryshueshme dhe anasjelltas.

Një zhvillim i tillë i ngjarjeve ndërthuret kryesisht me identifikimin dhe analizën e implikimeve të paradigmave të sigurisë së Maqedonisë në një kontekst bashkëkohor të vlerësimit të masave që do të anulonin perceptimet për rreziqet dhe pasigurinë, si nga jashtë ashtu edhe nga brenda. Qasja ndaj këtyre sfidave kërkon një analizë të rrethanave të reja të gjendjes së sigurisë në dy drejtime: në vija horizontale, duke analizuar sektorë shtesë që përbëjnë diskursin e rëndësishëm mbi sigurinë në Maqedoninë e Veriut; si dhe vertikale, duke pasur parasysh faktin se nivele të rëndësishme të sigurisë në

periudhën pas Luftës së Ftohtë përbëhen edhe nga njësi shtesë, që kërkojnë trajtim dhe qasje adekuate.

Për sa më sipër, duket qartë se sa i dobishëm është kërkimi i shkaqeve të tensioneve midis komuniteteve maqedonase dhe shqiptare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, jo vetëm në lidhje me çështjet emergjente dhe ngjarjet që ato shkaktojnë, por edhe në lidhje me faktorët strukturorë që formësojnë kornizën e një përplasjeje të tillë. Faktorë të tillë strukturorë, - sa për të përmendur disa - përfshijnë diskriminimin politik dhe pabarazitë ekonomike, shoqërore dhe kulturore. Këto elemente që gjenerojnë pakënaqësinë e njerëzve vazhdojnë të jenë të një rëndësie të madhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut

2. Qasjet teorike mbi sigurinë e përbashkët dhe identitetin

Karl Deutsch identifikon komunitetet e sigurisë si entitete ku ekziston një bindje e ndërsjellë se mosmarrëveshjet nuk do të zgjidhen me dhunë, por me mjete paqësore. Ai dallon dy forma të komuniteteve: pluraliste, ku shtetet janë sovrane dhe të pavarura, dhe të shkrira, ku shtetet ndajnë institucione të përbashkëta dhe identitete të ndara (Deutsch et al., 1957).

Adler dhe Barnett (1998) propozojnë një model evolucionar të ndërtimit të komuniteteve të sigurisë, duke filluar nga bashkëpunimi minimal institucional deri në një komunitet të sigurt dhe të pjekur, ku rregullat dhe institucionet janë të formësuara në praktikën politike.

Në këtë kuptim, siguria nuk është vetëm produkt i politikave shtetërore, por edhe i ndërveprimeve të përditshme dhe ndarjes së vlerave sociale që formojnë identitetin kolektiv institucional.

Për të shtjelluar më thellë qëllimin e punimit dhe për të shprehur rëndësinë e rolit të identitetit dhe formësimit të politikave të saj, do të orientohe mi tek një përkufizim i dhënë nga Buzan, i cili merr rastin e një shteti të përbërë nga tre elemente: ideja e shtetit, gjendja fizike e tij dhe shprehja institucionale. (Buzan, 1991)

Ky përkufizim na jep mundësinë e një qasjeje shumëpërmasore, që kombinon perspektivat historike në një situatë ndryshimi në marrëdhëniet mes shtetit dhe organizimit të atyre ideologjive që kanë si pasojë dinamikën e ndryshimit të qasjes ndaj paradigmave të sigurisë në formë apo në thelb. Nisur nga kjo, çështjet e natyrës së identitetit të shtetit do i analizojmë që nga fillimi e në vazhdim, në mënyrë që të kemi një pasqyrë më të qartë për konceptin dhe identitetin e shtetësisë dhe sovranitetit të Maqedonisë së Veriut. Në këtë mënyrë do të bëjmë disa shpjegime se si krijohen dhe formulohen interesat shtetërore apo si rrjedh ky proces nga perspektiva e aktorëve të përfshirë.

Baza fizike e shtetit nënkupton çështje si territori, kufijtë dhe popullsia, që janë të gjithë elementet që përbëjnë shtetin. Qëllimi i analizës në këtë drejtim është vëzhgimi i variablës së komuniteteve që përbëjnë shtetin dhe ndikimin e saj në korrelacion me çështjet e sigurisë.

Një qëndrim tjetër shtesë ka studiuesi Arnold Wolfers, sipas të cilit siguria mbulon jo vetëm një gamë mjete, por edhe qëllimesh, deri në atë shkallë sa politika të rrafshëve të ndryshme kombëtare të konsiderohen si politika të sigurisë, duke iu referuar asaj si një kuptim divergjent veprimesh, që përveç forcës ushtarake nënkuptojnë edhe një seri politikash të tjera që plotësojnë kërkesat e kombit, duke e planifikuar atë si një objektiv të politikës kombëtare. Ai e përkufizon sigurinë “si një vlerë nga e cila një shtet mund të aspirojë dhe të përfitojë më shumë ose më pak.” (Wolfers, 1952, f. 484)

Kjo bëhet përmes analizës së funksionit themelor të shtetit, për të siguruar dhe plotësuar nevojat e komunitetit në mënyrë të përshtatshme dhe në bazë të perceptimit të tyre në drejtim të asaj që përbën siguri për ta. Analiza e funksionit të shtetit dhe nevojave të komuniteteve nxjerr në pah se çfarë qasjeje percepton ai për komunitetet, inkluzive apo ekskluzive, dhe anasjelltas: si perceptohet ajo nga komunitetet.

Një hapësirë të rëndësishme në këtë kanë edhe aspektet normative/institucionale dhe dokumentet e rëndësishme që rregullojnë marrëdhëniet e brendshme dhe të jashtme të shtetit. Kjo bëhet gjatë paraqitjes së zhvillimeve mbi adoptimin e këtyre dokumenteve dhe në rastin e Maqedonisë janë dokumente që përkrijnë me shpalljen e pavarësisë më 1991 (si dhe kushtetuta e adoptuar po atë vit), mbi ndryshimet që ndodhën si rezultat i luftës së vitit 2001 dhe mbi aspiratat e shqiptarëve të Maqedonisë për një përfshirje të plotë si entitet i veçantë dhe shtetformues.

3. Integrimi dhe institucionalizimi si bazë për sigurinë e përbashkët të brendshme dhe të jashtme

Integrimi rajonal është një proces në të cilin shtetet krijojnë institucione të përbashkëta për të menaxhuar interesat e përbashkëta dhe për të zgjidhur konfliktet në mënyrë paqësore. Teoritë e institucionalizmit theksojnë rëndësinë e organizatave ndërkombëtare dhe të rregullave të përbashkëta si mjete për të kufizuar sjelljet oportuniste dhe për të ndërtuar besim (Keohane, 1984; Chrysoschoou, 2001). Përmes këtij kuadri, Bashkimi Evropian dhe NATO paraqiten jo vetëm si organizata politike dhe ushtarake, por edhe si komunitete normash dhe vlerash që promovojnë paqe dhe stabilitet përmes integrimit institucional.

Në rastin konkret është e rëndësishme një qasje shtesë për nevojat tona në shpjegimin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të sigurisë. Në këtë drejtim qasja konstruktiviste e drejton vëmendjen kah proceset shoqërore dhe kah thelbi i dyfishtë i normave që ndërmarrin një pozicion qendror nëpërmjet të cilit mund të kuptohen si proceset e brendshme ashtu edhe proceset politike ndërkombëtare. Sipas konstruktivizmit, një pozicion i tillë mundëson një analizë të përshtatshme në lidhje me potencialet e konfliktit ndërmjet normave të ndryshme konstruktive institucionale të nivelit shtetërorë, por edhe në

procesin me të cilin përshtaten normat në marrëdhëniet ndërkombëtare. (Katzenstein, 1996)

Pikëpamjet kryesore konstruktiviste përqendrohen në faktin se mjedisi në të cilin shtetet dhe aktorët e tjerë politikë veprojnë dhe identitetet politike janë të rëndësishme në perceptimet e ndërtuara në atë mjedis, duke spikatur se vlerat që ndërton shoqëria janë po aq të rëndësishme sa edhe asetet materiale që ajo posedon. Në bazë të kësaj, ambienti në të cilin shtetet dhe kombet veprojnë mund të përcaktojë më drejtë dhe saktë interesat shtetërore. (Katzenstein, 1996, 13)

Së këndejmi del se interesat e shteteve nuk paraqiten në mënyrë të pavarur, por si rezultat i mjedisit apo rrethanave të tyre. Konstruktivizmi promovon pikëpamje të ngjashme edhe në lidhje me kuptimin e sigurisë. Kështu, sipas këtij drejtimi, siguria nuk përbën një gjendje objektive, por atë çfarë bëjnë shtetet në kontekstin e brendshëm, dhe si pasojë ajo është e konstruktuar në mënyrë varshmërie në kornizat e marrëdhënieve ndërkombëtare. (Katzenstein, 1996, 4)

Përmes këtij kuadri, Bashkimi Evropian dhe NATO paraqiten jo vetëm si organizata politike dhe ushtarake, por edhe si komunitete normash dhe vlerash që promovojnë paqe dhe stabilitet përmes integritetit institucional.

4. Rasti i Maqedonisë së Veriut: Ndërtimi i identitetit dhe orientimi euroatlantik

Maqedonia e Veriut paraqet një shembull të një shteti që ka përqafuar konceptin e sigurisë së përbashkët përmes integritetit euroatlantik. Nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Ohrit (2001), vendi ka ndërmarrë reforma të thella institucionale, përfshirë në sektorin e sigurisë, me qëllim përafrimin me standardet e BE-së dhe NATO-s (Vankovska, 2008).

Qasja konstruktiviste në marrëdhëniet ndërkombëtare e sheh realitetin politik si të ndërtuar përmes ndërveprimeve shoqërore, normave dhe identiteteve të aktorëve. Në këtë kuptim, identiteti shtetëror dhe konceptet e interesit kombëtar nuk janë të dhëna natyrale, por formësohen nëpërmjet proceseve të ndërlikuara historike, kulturore dhe institucionale (Wendt, 1992; Katzenstein, 1996). Në kontekstin e Maqedonisë së Veriut, konstruktivizmi ndihmon të kuptohet mënyra se si përplasjet identitare dhe normat ndërmjet komuniteteve të ndryshme kanë ndikuar në zhvillimin e politikave të sigurisë dhe orientimit ndërkombëtar të shtetit.

Pas pavarësimit, shteti u përball me sfidën e krijimit të një identiteti gjithëpërfshirës që do të siguronte kohezion të brendshëm dhe do të mundësonte legjitimitetin e tij në skenën ndërkombëtare. Në këtë kontekst, konflikti i vitit 2001 midis forcave të armatosura shtetërore dhe Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK) nxori në pah përplasjen ndërmjet identiteteve konkurruese dhe mungesën e një narrative të përbashkët për shtetësinë. Marrëveshja e Ohrit

(2001) nuk ishte vetëm një dokument për ndaljen e konfliktit, por një pikë kthese në ndërtimin e normave të reja institucionale që përfshinin mekanizma të përfaqësimit të barabartë, njohjen e gjuhës shqipe dhe përfshirjen e komuniteteve në institucionet shtetërore (Vankovska, 2008).

Konstruktivizmi ndihmon të kuptohet ky transformim si një proces ku normat dhe identitetet janë bashkëformuese: nga një shtet i përkufizuar përmes një identiteti dominues etnik, drejt një shteti shumetnik me aspirata për të ndërtuar një identitet të ri qytetar dhe evropian. Këtu, roli i aktorëve ndërkombëtarë - BE dhe NATO - ka qenë vendimtar në ushtrimin e presionit pozitiv për ndryshime institucionale dhe në ofrimin e një kornize normative të përbashkët. Integrimi evropian, në këtë rast, nuk është vetëm një qëllim strategjik, por një mekanizëm për ndërtimin e normave të reja brenda. Institucionalizmi si teori e marrëdhënieve ndërkombëtare mbështet idenë se institucionet ndërkombëtare luajnë një rol qendror në promovimin e bashkëpunimit ndërmjet shteteve, duke krijuar rregulla të përbashkëta, transparencë dhe parashikueshmëri në veprimet ndërkombëtare (Keohane, 1984). Kjo qasje nuk mohon anarkinë e sistemit ndërkombëtar, por argumenton se përmes ndërtimit të institucioneve të qëndrueshme, shtetet mund të zvogëlojnë pasiguritë dhe të rrisin nivelin e bashkëpunimit.

Në rastin e Maqedonisë së Veriut, institucionalizmi ndihmon të kuptohet se si përmes afrimit me strukturat ndërkombëtare - si Bashkimi Evropian dhe NATO - vendi ka ndërtuar mekanizma për sigurimin e stabilitetit të brendshëm dhe për të siguruar përkrahje të jashtme në proceset e transformimit politik dhe shoqëror. Integrimi në këto organizata nuk është thjesht një synim politik, por një mjet për të transformuar strukturat institucionale dhe për të forcuar legjitimitetin e shtetit (Börzel & Risse, 2009).

BE-ja dhe NATO-ja, në këtë kontekst, nuk janë vetëm platforma për bashkëpunim ushtarak apo ekonomik, por ofrojnë një arkitekturë normative dhe institucionale që synon krijimin e një hapësire sigurie të përbashkët. Ato vendosin standarde për sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut, funksionimin e shtetit të së drejtës dhe përfshirjen e pakicave - të gjitha këto elemente që prekin drejtpërdrejt sigurinë e brendshme të një shteti (Adler & Barnett, 1998).

Në rastin e Maqedonisë së Veriut, procesi i integritetit në NATO (i përmbyllur në vitin 2020) dhe përpjekjet për t'u anëtarësuar në BE kanë sjellë reforma të thella në fusha si drejtësia, siguria, administrata publike dhe menaxhimi i sektorit të mbrojtjes (Elbasani & Vurmo, 2021). Për shembull, harmonizimi i legjisllacionit me *acquis communautaire* të BE-së nuk ka qenë vetëm një akt teknik, por një mekanizëm për përcimin e normave demokratike dhe standardeve të sigurisë në strukturat e brendshme shtetërore.

Institucionalizmi gjithashtu ndihmon të kuptohet sesi pjesëmarrja në struktura rajonale dhe ndërkombëtare, si Procesi i Berlinit, CEFTA, Këshilli Rajonal për Bashkëpunim (RCC), dhe nisma si Open Balkan, krijojnë një mjedis më të gjerë bashkëpunimi rajonal, ku siguria ndërlidhet me zhvillimin

ekonomik, infrastrukturën dhe marrëdhëniet ndëretnike. Kjo ndihmon në ndërtimin e besimit, në uljen e tensioneve dhe në përforcimin e stabilitetit afatgjatë të shtetit.

Një element tjetër thelbësor është ndërrimi i perceptimeve për sigurinë. Në linjë me konstruktivizmin, perceptimet për kërcënimet nuk janë objektive, por varen nga mënyra se si aktorët i kuptojnë dhe i përkufizojnë marrëdhëniet e tyre (Katzenstein, 1996). Në vitet pas Marrëveshjes së Ohrit, rritja e bashkëpunimit ndër-komunitar dhe zhvillimi i institucioneve përfshirëse ndihmuan në zbutjen e perceptimit të brendshëm të kërcënimit. Në të njëjtën kohë, përkrahja për integrimin euroatlantik nga shumica e aktorëve politikë u bë pjesë e një identiteti të ri të përbashkët, ku siguria dhe përkatësia politike filluan të konceptohen në terma transnacionalë.

Për më tepër, procesi i transformimit të identitetit dhe normave u thellua me Marrëveshjen e Prespës (2018), përmes së cilës Maqedonia e Veriut pranoi ndryshimin e emrit kushtetues si kompromis për të zhbllokuar integrimin në NATO dhe BE (Bechev, 2019). Ky hap ilustron qartë se identiteti shtetëror mund të jetë fleksibël dhe i negociueshëm kur e kërkon interesi strategjik, një ide thelbësore në konstruktivizëm. Ndryshimi i emrit nuk ishte thjesht një akt diplomatik, por një rikonceptim i mënyrës se si shteti e sheh veten në raport me fqinjët dhe komunitetin ndërkombëtar.

Në përfundim, nëpërmjet lenteve të konstruktivizmit, rasti i Maqedonisë së Veriut tregon se siguria nuk është një produkt i burimeve materiale apo kërcënimeve objektive, por i procesit të ndërtimit të përbashkët të normave dhe rrjedhimisht identitetit shtetërorë institucional. Ndërkombëtarizimi i këtyre normave përmes integritit në NATO dhe përpjekjeve për t'u anëtarësuar në BE, e ka përshpejtuar këtë proces transformues dhe ka vendosur themelet për një rend të ri të sigurisë, të bazuar në përkatësi, bashkëpunim dhe vlera të përbashkëta.

Conclusion

The interplay between identity and security in the context of international relations - particularly through approaches such as constructivism, institutionalism, and the concept of security communities - offers a deeper understanding of the nature of state transformations in the Western Balkans. The case of North Macedonia serves as an illustrative example of a state that, through internal reforms and external engagement, has moved from internal insecurity and ethnic division toward building an inclusive state identity and a Euro-Atlantic orientation.

In this process, the Ohrid Framework Agreement (2001) and the Prespa Agreement (2018) have served as key moments for redefining institutional identity and resetting interethnic and international relations. Constructivism helps explain that norms and identities are not given, but are instead the result

of social interaction and international engagement. Meanwhile, institutionalism emphasizes the central role of the EU and NATO in providing a normative and practical architecture that supports long-term security building.

In conclusion, the case of North Macedonia demonstrates that integration processes and interaction with international structures can serve as instruments for ensuring internal stability, building an inclusive identity, and joining a security community that transcends national borders - positioning the state as a responsible actor within a rules-based and cooperative international order.

Recensentë:

Prof. dr. Dashmir Idrizi

Prof. dr. Ebrar Ibraimi

Referenca:

1. Adler, E. & Barnett, M. (1998). *Security Communities*. Cambridge University Press.
2. Bechev, D. (2019). *Historical Dictionary of North Macedonia*. Rowman & Littlefield.
3. Börzel, T.A. & Risse, T. (2009). *The Transformative Power of Europe: The European Union and the Diffusion of Ideas*. KFG Working Paper Series, No. 1.
4. Chrysoschoou, D. (2001). *Theorizing European Integration*. Sage.
5. Deutsch, K.W., Burrell, S.A., Kann, R.A., Lee Jr., M., Lichterman, M., Lindgren, R.E., Loewenheim, F.L. & van Wagenen, R.W. (1957). *Political Community and the North Atlantic Area: International Organization in the Light of Historical Experience*. Princeton University Press.
6. Elbasani, A. & Vurmo, G. (2021). EU Enlargement in the Western Balkans: The Battle of Narratives. *Journal of Regional Security*, 16(1).
7. Elbasani, A. & Vurmo, G. (2021). EU Integration and State Capture in the Western Balkans: The Case of North Macedonia. *Southeast European and Black Sea Studies*, 21(1), pp. 63–80.
8. Katzenstein, P.J. (1996). *The Culture of National Security: Norms and Identity in World Politics*. Columbia University Press.
9. Keohane, R.O. (1984). *After Hegemony: Cooperation and Discord in the World Political Economy*. Princeton University Press.
10. Mitrany, D. (1996). *A Working Peace System: An Argument for the Functional Development of International Organization*. London: Institute for World Affairs.
11. Tzifakis, N. (2012). Western Balkans: EU's moment of truth. *The European Union Institute for Security Studies Briefs*, 11.

12. Vankovska, B. (2008). The Role of the Ohrid Framework Agreement and the Peace Process in Macedonia. In Bieber, F. (ed.) *Peacebuilding and Civil Society in Bosnia-Herzegovina*. Routledge, pp. 207–222.
13. Wolfers, A. (1952). “National Security” as an Ambiguous Symbol’, *Political Science Quarterly*, 67(4), pp. 481–502.